

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA TEKNIKE- OPERATIVE
Nr. 08-423/1
24.08.2022
Shkup

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për Agjencinë Teknike-Operative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 71/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Veriut” nr. 98/19), e duke u nisur nga angazhimet për sigurimin e respektimit të kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, profesionalizmit, integritetit, normave etike, besimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, drejtori i Agjencisë Teknike-Operative miratoi:

POLITIKË ANTIKORRUPTUESE TË AGJENCISË TEKNIKE-OPERATIVE
DHE
PLAN VJETOR PËR VLERËSIM DHE PARANDALIM TË RREZIQEVE NGA KORRUPSIONI
PËR PERIUdhËN 2022-2023

I. HYRJE

Agjencia Teknike-Operative (në tekstin e mëtutjeshëm: ATO), në funksion të angazhimit në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave, e përpiloi këtë dokument të programit në të cilin janë apostrofuar komponentë të rëndësishëm, janë përcaktuar parime të politikës antikorruptuese, dhe janë paraparë aktivitete të cilat duhet të realizohen gjatë vitit 2022 dhe gjatë vitit të ardhshëm 2023.

Dokumenti i programit i përcakton parimet, politikat, qëllimet prioritare si dhe masat dhe aktivitetet të cilat ATO-ja duhet t’i ndërmarrë në afate të caktuara në periudhën e planifikuar vijuese për realizimin e tyre dhe për krijimin e politikave përkatëse të cilat duhet të japin rezultate gjatë arritjes së qëllimeve të kësaj programe.

II. QËLLIMET E DOKUMENTIT

Ky dokument duhet të kontribuojë në pamundësimin dhe reduktimin e korrupsionit dhe të sigurojë besim më të lartë publik ndaj punës së ATO-s, si dhe rritje të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha sektorët dhe njësitë organizative në ATO.

Ky plan antikorruptues i ATO-s është dizajnuar për të vepruar fillimisht si preventivë, përkatësisht për reduktimin e rreziqeve nga korrupsioni përmes miratimit, harmonizimit dhe zbatimit të politikës antikorruptuese përkatëse, rregullativës, përforcimit të funksionalitetit të institucionit të sistemit për kthimin e besimit të publikut, rritjes së vetëdijes dhe përfshirjes së faktorëve relevantë dhe kompetentë në përpjekjet antikorruptuese.

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

Ky dokument bazohet në proceset dhe qëllimet objektive të cilat duhet të rezultojnë me pamundësim të vazhdueshëm të korrupsionit, ndërsa implementimi i tij do të kontribuojë në realizimin e jo vetëm të qëllimit institucional, por edhe të qëllimit më të gjerë shoqëror.

Me zhvillimin e komunikimeve, teknologjia informatike dhe këmbimi gjithnjë më i madh i informatave, ATO fokusohet në ndjekjen e trendëve bashkëkohore të zhvillimit harmonizimit gradual të domeneve të saj kryesore të punës me ritmin e zhvillimit të rrjedhave bashkëkohore. Së këndejmi, ATO është përqendruar në zhvillimin e politikave përkatëse dhe futjen e mjeteve digjitale praktike në transformimin digjital të institucionit, sektorit të drejtësisë dhe të sigurisë në tërësi, për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun e sigurisë, për përforsimin e sigurisë kibernetike dhe ngritjen e nivelit të vetëdijes së sigurisë të të punësuarit dhe shfrytëzuesit e informatave të klasifikuara dhe konfidenciale. Në atë drejtim shkon edhe përpunimi i këtij dokumenti i cili i përfshin politikat dhe aktet ekzistuese, si dhe të gjitha dokumentet dhe aktivitetet tjera që duhet të dalin nga ai.

Me përcaktimin e ATO-s për zhvillim strategjik të kapaciteteve të saj teknike dhe njerëzore, veprimi i ATO-s është në drejtim të avancimit dhe integritetit të sistemit të përgjithshëm për ndjekje të ligjshme, efikase dhe të sigurt të komunikimeve, i cili organeve të drejtësisë dhe organeve të autorizuar do t'u mundësojë luftë të palëkundur dhe të sigurt kundër krimit dhe korrupsionit të organizuar, njëkohësisht duke i kushtuar vëmendje të veçantë respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe kthimit të besimit të publikut.

III. NOCIONE, DEFINICIONE DHE PARIME

Nocioni i korrupsionit lidhet me përfitimin e dobisë personale kundërligjore të një individi ose grupi në dëm të financave publike dhe në përgjithësi, interesit publik në vend. Korrupsioni është dukuri dinamike dhe ajo mund të paraqitet në shumë forma të ndryshme nga të cilat më të shpeshta janë: Keqpërdorimi i detyrës zyrtare; Ryshfeti; Tregtia me ndikim; Shfrytëzimi i të mirave zyrtare për nevoja personale; Konflikti i interesave; Zhvatja; Nepotizmi; Kronizmi; Kontrata ndërmjet vete (dhënie kontratë firmës personale ose të farefisit) etj. Efektet negative nga korrupsioni janë jashtëzakonisht të mëdha dhe afatgjate, duke e përfshirë sektorin publik, privat dhe civil. Sjellja korruptuese e dëmton besimin në sektorin publik, institucionet, shfrytëzimin efikas të resurseve publike dhe përbën rrezik për shoqërinë për shkak të erozionit të vlerave.

Kategoria e cila detyrimisht shqyrtohet gjatë diskutimit për korrupsion është integriteti. Integriteti është cilësi e veprimit në pajtim me vlerat dhe normat e pranuar të përgjithshme morale në dobi të interesit publik. Integriteti dhe korrupsioni janë dy dukuri të kundërta, përkatësisht çdo veprim korruptues nënkupton shkelje të integritetit. Nga ana tjetër, jo çdo shkelje e integritetit do të thotë sjellje korruptuese. Në kontekst të parandalimit të korrupsionit, integriteti nënkupton – fuqinë që e ka një funksion i caktuar të përdoret ekskluzivisht për realizimin e qëllimeve të përcaktuara qartë dhe të deklaruara publikisht.

Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

Konceptimi i integritetit është pjesë përbërëse e sistemit të sundimit të mirë, në kuptim të ndërtimit dhe kultivimit të frymës së integritetit në nivel personal dhe institucional, me ç'rast do të nxitet dhe sigurohet pavarësia, profesionalizmi, llogaridhënia në zbatimin e kompetencave të përcaktuara me ligjet dhe rregullat tjera. Sistemi për integritet në organizatën e shënon përmbledhjen e të gjitha politikave, standardeve, procedurave të cilat e përforcojnë rezistencën e tij ndaj korrupsionit dhe e zvogëlon rrezikon nga sjelljet korruptuese nga të punësuarit në organizatën.

Dhënia dhe pranimi i dhuratave nxit krijim të një modeli të sjelljes korruptuese, në drejtim të inkurajimit të të menduarit te individët se me dhurata fitohet trajnim më i mirë, me ç'rast rritjet edhe vlera e dhuratave jashtë kufijve ligjore. Rregullativa ligjore përcakton masa ligjore, por zbatimi i kësaj rregullative në praktikë has në vështirësi. Personi zyrtar merr rrogë për punën e tij, ndërsa dhënia e dhuratës nga marrësi i shërbimit me vullneti të tij/saj si shenjë falënderimi për punën e kryer lejohet në pajtim me normat ligjore. Nevojitet angazhim dhe përkushtim në kuadër të institucionit për rregullim, kontrollim të këtij lloji të a.q. "korrupsion i vogël" sepse kundrejt mendimit se i njëjti nuk shkakton dëm të madh, duhet të theksohen efektet kumulative (financiare), si dhe efektet mbi vlerat etike në shoqërinë që të vlerësohet ndikimi i vërtetë dhe afatgjatë i "zakonit" në dhënien/marrjen e dhuratave.

Në Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 12/2019) nocionet dhe parimet e përcaktuara janë rregulluar në mënyrën në vijim:

- **"korrupsioni"**, në kuptim të ligjit, nënkuptohet keqpërdorim të funksionit, autorizimit publik, detyrës ose pozitës zyrtare për realizim të dobisë, drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësimit, për vete ose për tjetër dhe i përfshin edhe nocionet:
- **korrupsioni pasiv** – veprim i qëllimshëm i personit zyrtar, i cili drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësuesit, kërkon ose merr dobi të cilitdo lloj, për vete ose për personin e tretë, ose pranon premtim të dobisë së tillë, me qëllim për të vepruar ose të përmbahet nga veprimi në pajtim me detyrimet e veta ose t'i kryejë kompetencat e tij në kundërshtim me detyrimet zyrtare dhe
- **"korrupsioni aktiv"** – veprimi i qëllimshëm i cilitdo personi i cili drejtpërdrejtë ose përmes ndërmjetësuesit i premtim ose jep dobi të cilitdo lloj personit zyrtar, për të ose për person të tretë, me qëllim për të vepruar ose për t'u përmbajtur nga veprimi në pajtim me detyrimet e tij ose t'i kryejë kompetencat e tij në kundërshtim me detyrimet zyrtare.
- **"konflikt interesi"** është gjendja në të cilën personi zyrtar ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë mbi kryerjen e paanshme të autorizimeve të tij publike ose detyrave zyrtare.
- Secili është i detyruar që gjatë kryerjes së funksionit, autorizimeve publike dhe detyrës zyrtare të veprojë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet.

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

- Askush nuk guxon ta shfrytëzojë funksionin, autorizimet publike, detyrën zyrtare dhe pozitën për kryerje ose lëshim të veprimit që sipas ligjit nuk guxon, përkatësisht duhet doemos ta kryejë, as ta kryejë veprimin e ligjshëm për interesin e tij personal, as për interesin e askujt tjetër.
- Askush nuk mund të thirret në përgjegjësi për korrupsion përveç në rastet dhe kushtet e parapara me këtë ligj, me Ligjin penal dhe ligj tjetër në procedurë të përcaktuar me ligj.
- Secili është i detyruar që në kryerjen e funksionit, autorizimeve publike dhe detyrës zyrtare të veprojë në mënyrë të vetëdijshme, profesionale, të përgjegjshme, të sinqertë, efikase dhe të paanshme.
- Personi zyrtar në kryerjen e autorizimeve dhe detyrave publike është i detyruar që t'i respektojë parimin e ligjshmërisë, parimin e barazisë, parimin e transparencës, normat etike dhe standardet profesionale, pa diskriminim ose privilegj të cilitdo duke respektuar plotësisht interesin publik.
- Personi zyrtar në kryerjen e funksionit të tij është i detyruar që të ketë kujdes në konfliktin eventual të interesave dhe gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave publike nuk guxon të udhëhiqet nga interesat personale, familjare, fetare, partiake dhe etnike, as nga presionet dhe premtimet nga eprori ose nga personi tjetër.
- Ushtrimi i pushtetit, funksionit, autorizimeve publike, detyrës zyrtare dhe kryerja e punëve me interes publik janë publike dhe të nënshtruara ndaj kontrollit publik.
- Askush nuk mund të thirret në zbatim të ligjit ose rregulle tjetër me të cilin do të kufizohet ose përjashtohet transparenca për të mbuluar korrupsionin ose konfliktin e interesave.
- Çdokush ka të drejtë të denoncojë dyshim ose njohuri për korrupsion dhe të mbrohet në pajtim me ligjin.

IV. RREGULLATIVA RELEVANTE

Ekzistojnë disa akte ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë, përkatësisht përcaktojnë procedura dhe dispozita materiale në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Megjithatë më të rëndësishmet janë: Kushtetuta e RMV-së, Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Strategjia Kombëtare për Parandalim të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave 2021-2025, Ligji për prokurimet publike dhe aktet nënligjore që dalin nga ato ndër të cilat edhe Kodi i sjelljes gjatë realizimit të prokurimeve publike, si dhe Ligji për prokurime publike në sferën e mbrojtjes dhe sigurisë, Ligji për të punësuarit në sektorin publik, Ligji për marrëdhënie pune, Ligji për kontroll të brendshëm publik financiar, Ligji për mbrojtje të sinjalizuesve, Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik, Kodi Penal, Ligji për lobim, Ligji për informata të klasifikuara, Rregullore për denoncim të brendshëm të mbrojtur, Rregullore për denoncim të jashtë të mbrojtur. Në angazhim të komunitetit ndërkombëtar në luftë kundër korrupsionit janë miratuar Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

dhe Konventa civile për parandalimi të korrupsionit, të cilat meqë Republika e Maqedonisë së Veriut i ka ratifikuar këto dokumente juridike të njëjtat paraqesin pjesë të rendit juridik vendor, si dhe dokumentet dhe udhëzimet e GREKO. Në aspekt të planeve dhe programeve që janë me rëndësi strategjike për funksionimin e ATO-s dhe si rrjedhojë e kësaj për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave janë edhe aktet relevante ligjore dhe nënligjore nga të cilat i rregullojnë organizatën, kompetencën, udhëheqjen dhe punën e ATO-s, si dhe të gjitha aktet nënligjore dhe interne të miratuara në kuadër të ATO-s, duke theksuar: Ligjin për Agjencinë Teknike-Operative, Ligjin për ndjekje të komunikimeve, Rregulloren për mënyrën e veprimit të operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale nga ATO, Rregulloren për masat dhe standardet për siguri informative, Rregulloren për legjitimacion zyrtar dhe distinktiv, Kodin etik për të punësuarit dhe persona tjerë që kryejnë punë në Agjencinë Teknike-Operative, Strategjinë e ATO-s 2022-2024 dhe planet strategjike dhe të gjitha aktet tjera ekzistuese interne për realizimin e prokurimeve për përzgjedhje gjatë punësimit, për veprimin e të punësuarve, për rendin e brendshëm dhe aktet tjera.

V. POLITIKA ANTIKORRUPTUESE E ATO

ATO i miraton parimet vijuese të politikës antikorruptuese:

- ATO nuk toleron sjellje korruptuese, përkatësisht shfrytëzim të funksionit, autorizimit publik, detyrës dhe pozitës zyrtare për realizim të çfarëdo dobie të të punësuarve dhe/ose të afërmit të tij.
- ATO nuk toleron çfarëdo forme të sjelljes joetike dhe jomorale të ndaluar me ligj dhe në kundërshtim me Kodin Etik, për të punësuarit dhe personat tjerë që kryejnë punë në Agjencinë Teknike-Operative.

Drejtori dhe personat udhëheqës në ATO janë përgjegjës për vlerësim dhe mënjanim të rreziqeve që kontribuojnë për korrupsion, keqpërdorim, vjedhje, ryshfet, konflikt interesash si dhe shfrytëzim të ndikimeve dhe lidhje me qëllim fitimin e trajtimit të privilegjuar ose çfarëdo forme tjetër të sjelljes joetike dhe joligjore.

Të punësuarit, përkatësisht personat zyrtarë janë të detyruar që të sillen në mënyrë të sqertë dhe të përgjegjshme dhe t'i respektojnë procedurat dhe afatet e përcaktuara për veprim, që kompetencat e ATO-s të jenë besnike ndaj institucionit, e jo ndaj organizatave dhe personave tjerë (nga sektori privat, publik, shoqatat, organizatat, partitë politike...) të shmangin konflikt të interesave dhe të kujdesen për imazhin e institucionit në publik në çdo kohë.

Nga të gjithë të punësuarit në ATO pritet t'u përmbahen rregullave në vijim:

- Të synojnë standardin më të lartë të mundshëm të shërbimit, përmes procedurave të përcaktuara dhe të vendosura dhe pa frikë për të treguar çfarëdo mangësi, dobësi potenciale të kontrollit të brendshëm ose procedurave joadekuate;

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

- T'i përmbahen Kushtetutës dhe të gjitha ligjeve, rregullave dhe politikave që janë të zbatueshme;
- Të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të i japin trajtim preferencial cilësdo organizatë private ose publike ose cilitdo individ;
- Të synojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e pronës dhe mjeteve publike;
- Zbulimi dhe informimi në kohë i aktiviteteve joligjore, mashtrimit, keqpërdorimit dhe korrupsionit;
- Të insistojnë të shmangin çfarëdo aktivitete që do të krijojnë pamje se i shkelin ligjin ose standardet etnike;
- Të bëjnë përpjekje të sinqerta në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të tyre të punës;
- T'u përmbahen dispozitave të legjislacionit relevant për konfidencialitet, si dhe legjislacionit për informata të klasifikuara;
- Të mos sigurojnë ose ndihmojnë tjetër të fitojë çfarëdo dobie ose interesi, si dhe të mos spekulojnë ose ndihmojnë tjetër për të spekuluar në bazë të informatave;
- T mos veprojnë me qëllim për të fituar dobi ose për të dëmtuar ose qëllimisht dhe/ose me vetëdije të keqpërdorin vlerë që i përket ATO-s dhe/ose shtetit.
- Të mos përvetësojnë mjete financiare të cilat janë në kundërshtim me kryerjen e vetëdijshme të detyrave dhe përgjegjësi të tyre zyrtare;
- Të mos merren me çfarëdo transaksioni financiar ose tjetër me interes, me qëllim për të realizuar çfarëdo interesi privat duke shfrytëzuar informata publike dhe/ose jopublike që i marrin gjatë punës së tyre;
- Të mos ndërmarrin detyrime ose premtime të paautorizuara të cilitdo lloji;
- Të mos vendosen nën çfarëdo obligimi financiar ose tjetër ndaj personave të jashtëm ose organizatave private/publike që mund të ndikojnë mbi to në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare;
- Të gjitha prezencat në konferenca ose në evenimente tjera, seminare, trajnime ose mbledhje të ngjashme duhet të aprovohen nga strukturat dhe të jenë të dobishme për ATO-n dhe për trajnim dhe zhvillim të të punësuarve.
- Të mos merren me punësim të jashtëm ose aktivitete, përfshirë edhe kërkesën ose negociimin për punësim, gjë që është në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë zyrtare;
- Asnjë person i punësuar nuk guxon të kërkojë, të japë këshilla, të pajtohet të japë, pranojë ose të pajtohet të pranojë çfarëdo dobie si zëvendësim për vendimin e tij, mendimin, rekomandimin, votimin ose praktikë tjetër të fuqisë zyrtare ose diskrecionit;
- Të punësuarit që kanë diskrecion në lidhje me kontratat, prokurimet, pagesat, kërkesat dhe transaksionet tjera në para, nuk mund të kërkojnë, pranojnë ose të pajtohen të pranojnë çfarëdo dobie nga cilitdo person për të cilin personat e punësuar dinë se janë të interesuar ose sigurisht do të interesohen për cilëndo kontratë, blerje pagesë, kërkesë ose transaksion që përfshin diskrecion të cilitdo person të punësuar;

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

- Të punësuarit duhet të jenë të vetëdijshëm se veprë penale korrupsion është të pranohet ose jepet në mënyrë joligjore dhuratë, honorar, shpërblim ose përparësi për bërje ose mosrespektim të çfarëdo qoftë ose tregim të animit dhe sjellje të pahijshme të cilitdo person në cilësi të tyre zyrtare dhe nëse paraqitet akuzë, duhet të tregohet se shpërblimet e tilla nuk janë marrë në mënyrë korruptuese.
- Të punësuarit të cilëve u është ofruar ryshfet ose janë nxitur në veprime joligjore dhe joetike duhet ta ndërpresin komunikimin me personin i cili ofron ryshfet për ta njoftuar personin kompetent në ATO, i punësuar duhet t'i sqarojë detajet përfshirë edhe kohën, vendin, bashkëbiseduesit dhe lëndën e bisedës.
- Nëse i punësuar nuk vepron në pajtim me procedurat e përcaktuara, kundër tij do të ngrihet procedurë adekuate për konstatimin e përgjegjësisë, e nëse konstatohet një gjë e tillë, do të shqiptohet dënim.
- Në ATO janë emëruar persona të autorizuar, por mund të formohet edhe komision/grup pune për ndërmarrje të aktiviteteve për realizim, ndjekje dhe koordinim të sistemit të vendosur për integritet (grup pune për integritet).
- Parandalimi kundër korrupsionit – personat e autorizuar, përkatësisht komisioni/grupi i punës për integritet do të mbajë rregullisht mbledhje me udhëheqësit dhe do të realizojë trajnime me qëllim për të sqaruar pasojat e dëmshme nga sjellja korruptuese. Njëkohësisht do të punojë edhe në rritjen e vetëdijes së të punësuarve për sistemin e integritetit në ATO dhe për respektimin e tij konsequent.
- Pas pranimit të denoncimit për ryshfet, korrupsion dhe konflikt të interesave, personat e autorizuar dhe grupi i punës për integritet duhet t'i mbledhin informatat e nevojshme për rastin përkatës dhe t'i dërgojë denoncim Komisionit Shtetëror për Parandalim në Formë të Shtypur ose në formë elektronike.
- Personi zyrtar në ATO nuk guxon ta keqpërdor pozitën e tij për realizim të dobisë, me ç'rast si punë me interes publik konsiderohen edhe aktivitetet që kryhen në kuadër të veprimit të partive politike, sindikatave, shoqatave dhe fondacioneve.
- Veprimi në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave – personi zyrtar në ATO, në punën e tij është i detyruar që të ketë kujdes në konfliktin potencial të interesave dhe të ndërmarrë masa për shmangien e tij.
- Në rast të dyshimit të ekzistimit të konfliktit të interesave, personi zyrtar në ATO është i detyruar që t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për ta parandaluar ndikimin e interesit të tij/ose privat mbi person tjetër (fizik, juridik, organ, organizatë etj) mbi kryerjen e autorizimeve dhe detyrave të tij dhe për atë ta njoftojë eprorin e tij drejtuar drejtorit të ATO-s.
- Në rast të ekzistimit të dyshimit për konflikt të interesave, personi zyrtar është i detyruar që të kërkojë mendim nga KSHPK-ja.
- Paraqitja e gjendjes së konfliktit të interesave – nëse personi zyrtar në ATO merr pjesë në diskutimin e organit ose trupit në të cilin vendoset për punë për të cilat ai ose personi i afërt ka interes privat, personi zyrtar është i detyruar që ta paraqesë

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

ekzistimin e interesit privat dhe të përjashtohet para diskutimit dhe vendimmarrjes, e më së voni para fillimit të vendimmarrjes.

- Mbulimi i ekzistimit të interesit privat për personin zyrtar ose personin tjetër paraqet shkelje të detyrës nga ana e personit zyrtar dhe batë për mbulim të procedurës për konstatim të përgjegjësisë dhe shqiptim të masave në pajtim me ligjin.
- Personi zyrtar në ATO i cili merr pjesë ose vendos në procedurën për zgjedhje, emërim ose punësim ose është përfshirë si anëtar i trupit, komisionit, grupit ose ngjashëm që e zbaton atë procedurë është i detyruar që ta njoftojë personin udhëheqës drejtuar drejtorit të ATO-s për të gjitha procedurat që mund të shkaktojnë konflikt të interesave.
- Pas konstatimit të raportit të personit zyrtar me kandidatin (për zgjedhje, për lidhje të kontratës, për punësim/angazhim), drejtori i ATO-s është i detyruar që t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për parandalim të paraqitjes së konfliktit të interesave.
- Në rast të dyshimit nëse ekziston konflikt interesi, personi zyrtar ose drejtori i ATO-s mund të kërkojnë mendim nga KSHPK.
- Ndalim për pranim të dhuratave – personi zyrtar gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave publike nuk guxon të pranojë dhurata, përveç nëse në rastet në shumën dhe në mënyrë të përcaktuara me ligj.
- Të punësuarit janë të detyruar që të paraqesin çfarëdo sjellje korruptuese në mënyrë të përcaktuar në procedurat për paraqitje të rasteve në të cilat ekziston dyshim për korrupsion ose sjellje tjetër joetike.
- Denoncimi i sjelljes korruptuese të personave që janë të punësuar në ATO është detyrë e secilit. Kjo nuk është çështje personale, as e drejtë e zgjedhjes, por është pjesë e detyrës zyrtare dhe përgjegjësisë.
- Të punësuarit i cili denoncon korrupsion i garantohet se informatat janë plotësisht konfidenciale.
- Të punësuarit që kanë qenë dëshmitarë ose kanë dyshime themelore për sjellje joetike ose joligjore të të punësuarve në ATO duhet doemos në formë të shtypur, përmes telefonit ose përmes postës elektronike ta informojnë personin/at e autorizuar/komisionet në ATO.
- Për denoncimet anonime do të vepohet vetëm nëse përmbajnë të dhëna të mjaftueshme të cilët do të sigurojnë konstatim të gjendjes faktike.
- Drejtori dhe strukturat udhëheqëse të ATO-s, në bazë të bindjes së sinqertë se denoncimi bazohet në të vërtetën, e garantojnë të drejtën e mbrojtjes nga hakmarrja dhe kërcënimet ndaj personave që kanë denoncuar sjelljen joetike dhe joligjore.
- Nëse dëshmohet e personi në mënyrë tendencioze dhe keqdashëse e ka denoncuar dh/ose ka dhënë deklaratë të rrejshme, kundër tij do të ndërmerren masa adekuate të përgjegjësisë.
- Sjelljet korruptuese janë të ndëshkueshme në pajtim me Kodin Penal, e aktet korruptuese dhe sjellja joetike të përcaktuara me politikën antikorrupuese,

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

detyrimisht tërheqin ngritje të procedurës disiplinore, e cila nuk përjashton edhe përgjegjësi penale.

- Asgjë që është e përfshirë në këtë politikë antikorrupuese nuk është faktor kufizues për të punësuarit në aspekt të denoncimit të veprave penale te organet kompetente.

Duke u nisur nga e lartpërmendura, duke e prioritetizuar interesin publik, njëkohësisht për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarit dhe besimin e publikut, ATO zotohet në mënyrë të vendosur dhe i respekton parimet e ligjshmërisë, integritetit, barazisë, transparencës, mbrojtjes dhe përgjegjësisë, me theks të veçantë në integritetin e të punësuarve, profesionalizmin, kompetencën e tyre, sensibilizimin e tyre ndaj të dhënave konfidenciale, të klasifikuara dhe të sigurta.

VI. PLANI VJETOR PËR VLERËSIM DHE PARANDALIM TË RREZIQEVE NË ATO PËR 2022-2023

Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit në ATO për periudhën 2022-2023 përbëhet në vendosjen dhe angazhimin për përmbushje konsekuente të qëllimeve në vijim:

1. Zbatim të kompetencave të ATO-s në mënyrë të ligjshme, transparente, etike, ekonomike, të përgjegjshme dhe efektive.

Agjenci neutrale profesionale dhe politike e cila vepron në mënyrë të drejtë, transparente, etike, ekonomike, llogaridhënëse dhe efektive është parimi themelor për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e besimit të publikut ndaj institucionit.

2. Sigurimi i integritetit dhe transparencës gjatë punësimit në ATO, në pajtim me sistemin e vlerave dhe kriterëve për cilësi dhe kontrolle të sigurisë në pajtim me Ligjin

Politikë e drejtë, e bazuar në merita dhe e depolitizuar për resurse njerëzore është baza për ndërtimin e kuadrit kompetent dhe profesional. Gjatë punësimit, nevojitet të respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara, të përfshihen sa më shumë kriterë matëse për vlerësim të kandidatëve në procedurë për zgjedhje, të sigurohen kontrolle të sigurisë nga institucione kompetente, të kontrolluar dhe në situata veçanërisht të arsyeshme përdorim të fuqisë diskrecionale të funksionarit i cili zgjedh dhe insistimi për transparencë sa më të madhe të procedurës, në pajtim me ligjin, duke u kushtuar vëmendje kufizimeve të nevojshme në drejtim të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale dhe të klasifikuara, sekreteve afariste dhe zyrtare.

3. Përforcimi i mekanizmave mbikëqyrëse dhe kontrolluese

Për zbatim të drejtë të akteve të miratuara ligjore, nënligjore dhe interne, si dhe për parandalim të parregullsive dhe gjetje të zgjidhjeve për korrupsion është i domosdoshëm përforcimi i mekanizmave për kontroll, mbikëqyrje dhe verifikim, përmirësimi i kornizës

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

juridike dhe resurseve financiare, njerëzore dhe materiale, si dhe përforsimi njohurive dhe shkathtësive të të punësuarve dhe rezistencës e tyre ndaj korrupsionit.

4. Digjitalizimi i proceseve

Digjitalizimi i proceseve në kompetencë dhe në kuadër të ATO-s, e përmirëson efikasitetin gjatë punës, i përshpejton proceset, e redukton kontaktin njerëzor dhe mundësitë për korrupsion, mundëson transparencë të lartë në të gjitha nivelet, e përmirëson bashkëveprimin ndërmjet pjesëmarrësve, dhe i lehtëson kontrollet, analizat e të dhënave dhe zbulimin e korrupsionit.

5. Zero korrupsion gjatë prokurimeve, kontrollit të zbatimit të marrëveshjeve duke respektuar disiplinën financiare

Të vepohet në drejtim të respektimit dhe mbrojtjes së resurseve publike gjatë prokurimeve, që të merret vlera më e mirë për shpenzimet publike, të sigurohet konkurrencë e drejtë në procedurat dhe trajtimin e drejtë të ofertuesve, është e domosdoshme të arrihet niveli më i lartë i transparencës së proceseve (duke i respektuar dispozitat e konfidencialitetit dhe informatave të klasifikuara), përmirësim të sistemeve elektronike bashkëkohore, investim i vazhdueshëm në arsimin e resurseve njerëzore dhe integritetit të tyre, si dhe të inkurajohet paraqitja e parregullsisve dhe të mbikëqyret procesi i përgjithshëm, përfshirë edhe kontrollet e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura.

Planifikim i saktë dhe preciz i procedurave për prokurime (publike), në afatin ligjor dhe të përcaktuar.

Publikimi i planeve të disponueshme dhe dokumentacionit të plotë, në pajtim me rregullat ligjore përmes përdorimit të sistemit elektronik të prokurimeve publike dhe publikimi në BPP dhe faqen e internetit të ATO-s.

Personi zyrtar nuk guxon të kryejë ndikim joligjor në procedurën për prokurim (publik). Sistemi i prokurimeve publike bazohet në parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, lirisë së themelimit, lirisë së sigurimit të shërbimeve, si dhe parimet e ekonomizimit, efikasitetit, konkurrencës ndërmjet operatorëve, transparencës, trajtimit të barabartë dhe përpjesëtim.

Edukimi profesional i të punësuarve përmes përsosjes së njohurive, trajnimeve të zbatimit praktik të Ligjit për prokurime publike dhe trajnimeve për antikorrupsion, integritet dhe parandalim të konfliktit të interesave në procedurat për prokurime publike.

Kontrolli i zbatimit të marrëveshjeve është i nevojshëm për shkak të realizimit efikas, preciz, cilësor të lëndës së marrëveshjeve. Marrëveshjet duhet të realizohen në mënyrë të vetëdijshme, sipas nevojave dhe të kontrollohet dhe vlerësohet cilësia e realizimit të tyre, e në rast të detektimit të praktikave të caktuara korruptuese për ato të alarmohet dhe të zbatohet procedurë përkatëse në pajtim me ligjin. Disiplina financiare është gjendje në të cilën të gjithë pjesëmarrësit e tregut i plotësojnë obligimet e tyre në kuadër të afateve ligjore dhe të dakorduara. Tendenca për çdo ekonomi nacionale është mbajtja në nivel të lartë të disiplinës financiare, sepse në atë mënyrë reduktohen rreziqet dhe shpenzimet e punës, ndërsa nxitet edhe rritja ekonomike afatgjate. Në mungesë të disiplinës financiare paraqiten numër i madh

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

i pasojave, me të cilave: rritja e rreziqeve; rritja e shpenzimeve të transaksioneve; konkurrenca joefikase; çekuilibër në ekuilibrin tregtar, ngadalësim i rritjes ekonomike etj.

6. Rritja e vetëdijes dhe realizimi i edukimit antikorrupsues

Rritja e vetëdijes antikorrupsuese dhe etika te të punësuarit është e nevojshme sepse personaliteti i informuar me integritet është kryesor në luftën kundër korrupsionit. Krahas aktiviteteve për vetëdijen e përgjithshme, grupet e synuara të të punësuarve duhet të trajnohen në mënyrë periodike për të kuptuar pasojat e dëmshme të korrupsionit, mjetet dhe etikën antikorrupsuese.

Me qëllim për të reduktuar mundësitë dhe hapësirën për veprim korrupsues, nevojitet përkufizim preciz të rregullativës në të gjitha sferat, në veçanti në ato kritike me rreziqe të larta të korrupsionit, implementim të ligjeve dhe sanksionim në kohë të rasteve të korrupsionit.

7. Përforcimi i politikës antikorrupsuese

ATO zotohet për ndjekje të vazhdueshme të rregullativave, standardeve dhe praktikave në sferën e mbrojtjes nga korrupsioni dhe konflikti i interesave me çka në vazhdimësi do të punojë për realizim të aktiviteteve për parandalim dhe për përballje adekuate dhe në kohë me rreziqet dhe pasojat nga korrupsioni.

VII. PLANI I VEPRIMIT, NDJEKJA, EVALUIMI DHE NJOFTIMI PËR ZBATIM TË POLITIKËS ANTIKORRUPTUESE TË ATO DHE REALIZIMI I PLANIT VJETOR

Drejtori dhe personat e autorizuar janë kompetentë për ndjekje të zbatimit të politikës antikorrupsuese të ATO-s dhe realizimin e Planit vjetor dhe aktiviteteve të përcaktuara në të.

Për shkak të realizimit të qëllimeve prioritare të planit vjetor për parandalim të korrupsionit në ATO për periudhën 2022-2023, drejtori i ATO-s miraton Plan veprim në të cilin krahas qëllimeve të vendosura, janë paraparë masat dhe aktivitetet të cilat në afate të caktuara në periudhën e ardhshme të planifikuar ATO-ja duhet t'i ndër marrë për realizim të tyre.

Varësisht nga nevojat, përmbajtja e Politikës antikorrupsuese të ATO-s dhe Planit vjetor mund të jetë objekt i ndryshimeve dhe plotësimeve.

Ndjekja dhe njoftimi për zbatim të masave dhe aktiviteteve të ndërmarra për planin vjetor është bazuar në sigurimin dhe përpunimin e të dhënave për nevojat e përpunimit të një raporti vjetor, e sipas nevojës edhe raporte të jashtëzakonshme gjatë rasteve të identifikuar të korrupsionit.

Mjetet financiare për realizim të aktiviteteve të këtij plani vjetor janë siguruar përmes buxhetit të ATO-s, ndërsa personat e autorizuar, të punësuarit kompetent dhe njësitë organizative i realizojnë si pjesë e detyrave të rregullta të punës.

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE

VIII. REZYME PËRFUNDIMTARE

Politika antikorrupuese dhe plani vjetor për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave me plan veprimin për zbatim është dokument të cilin e miraton drejtori i ATO-s.

Ai hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe përfshin periudhë prej dy vitesh, përkatësisht ka të bëjë me periudhën shtator 2022 – shtator 2023.

Në këtë dokument të programit janë marrë parasysh edhe pjesë të bartura nga dokumentet nacionale relevante të Strategjisë dhe pjesë të teksteve të dokumenteve për luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave të KSHPK.

Me realizimin e parimeve të politikës antikorrupuese, si dhe me përmbushjen e qëllimeve dhe masave nga plani vjetor për vitin e ardhshëm, duhet të sigurohet rritja e besimit ndaj zbatimit të veprimtarisë së ATO-s, shfrytëzimi efikas i resurseve publike dhe përforcimi i demokracisë dhe besimit ndaj institucionit, vlerat shoqërore dhe realizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.

AGJENCIA TEKNIKE- OPERATIVE

DREJTOR

Zoran Angellovski